



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER VASIL MARTINI
ADRESA Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2 ,
Lezhe
TEL: 0682049692

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2455

Nr. koleksioni: 1531

Lezhe më 10/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023043370159956815



LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE



Sot, më datë 10/06/2023, para meje Noter VASIL MARTINI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Lezhe, Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2, Lezhe, u paraqit personalisht:

KËRKUESJA:

Rudina Nikulaj, atësia Engjell, amësia Zira, shtetase Shqiptare, lindur në Manëz, Durrës dhe banues në LEZHË, me adresë Rreze Mali 03090035; Nd. 2; H. 1; Balldren; 4504; Lezhë, lindur më 01/09/1976, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035834492 dhe nr. personal H65901044A.

TRASHËGIMLËNËS:

Ardian Nikulaj, atësia Luigj, amësia Prenë, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë dhe banues në adresë Rreze Mali 03090035; Nd. 2; H. 1; Balldren; 4504; Lezhë, lindur më 31/10/1972, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034749907 dhe nr. personal H21031016O.

OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Ardian Luigj Nikulaj**.

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Unë Noteri kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Shkoder, përkatësisht Noter Vasil Martini, me zyrë Noterie në Lezhe, Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2, Lezhe, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Ardian Nikulaj, atësia Luigj, amësia Prenë, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë me datë 31/10/1972 me banim në Balldren, Lezhë, dhe vdekur me 19/04/2023, se kërkesja është bashkëshortja i të ndjerit Ardian Nikulaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka interes të ligjshëm në këtë gjykim, pra legjitimohet të paraqesë kërkimin para kësaj Zyre Noteriale.

Gjithashtu zyra ime noteriale ne Lezhe, në bazë të nenit 348 të Kodit Civile, ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit rezulton të ketë qenë në Lezhë.

Në lidhje me pretendimin e kërkuar, para noterit u shtruan për zgjidhje këto çështje:

- 1.përcaktimi i trashëgimtarëve të trashëgimlënësit të kërkuar nga kërkuarja.
- 2.pjesët takuese të secilit prej tyre.

Për të zgjidhur këto probleme, une noteri i referohem nenit 318 të Kodit Civil, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të secilit, bën të zbatueshëm



ligjin e kohës së çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga verifikimi rezulton e provuar se: më datë 19/04/2023 ka vdekur trashëgimlënësi Ardian Nikulaj fakt që provohet nga Certifikata e tij e vdekjes e leshuar nga zyra e Gjendjes Civile Balldren, me datë 05/06/2023 në rastin konkret ligji i zbatueshëm është Kodi Civil i vitit 1994 dhe meqenëse nga hetimi nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, në bazë të nenit 317 të Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore. Neni 361 i Kodit Civil aktual, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorten dhe fëmijët me formulimin: «**Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta**».

Nga certifikata e përbërjes familjare datë 05/06/2023 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Balldren, sipas regjistrimit të popullsisë për vitet 2010 rezulton se i ndjeri, ka qënë i martuar me shtetasen **Rudina Nikulaj**, me atësi Engjell dhe amësi Zira e lindur në Manëz, Durrës me 01/09/1976, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr. H65901044A. Nga lidhja martesore u kane lindur 2 fëmijë, përkatësisht:

1-Ambra Nikulaj me atësi Ardian dhe amësi Rudina e lindur në Lezhë me 20/01/2002 me banim në Lezhë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr.K25120022R.

2-Andri Nikulaj me atësi Ardian dhe amësi Rudina i lindur në Lezhë me 10/06/2004 me banim në Lezhë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr.K40610053D.

Gjithashtu rezulton që trashëgimlënësi ka pasur 2 fëmijë të lindur jashtë martese dhe bazuar në nenin 362 të Kodit Civil ku përcaktohet: **“Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa.”**, ato janë trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit, e konkretisht:

1-Gleida Nikulaj me atësi Ardian dhe amësi Vera e lindur në Lezhë me 28/10/2003 me banim në Lezhë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr.K36028081W.

2-Luis Nikulaj me atësi Ardian dhe amësi Vera i lindur në Lezhë me 05/05/2010 me banim në Lezhë, identifikuar me letërnjoftim nr.L00505038V.

Nga verifikimi nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e mësipërm të ketë hequr dorë nga trashëgimi, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate, apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia e babait të tyre.

Gjithashtu nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë pasur martesa të mëparshme, apo fëmijë të birësuar.

Kërkuesja me deklaroi se nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjore, përveç atyre të pasqyruar në trungun familjar dhe të pasqyruar në certifikatat e lindjeve të depozituara prej saj.

Për sa më lart, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit Ardian Nikulaj janë bashkëshortja e tij Rudina Nikulaj dhe fëmijët e tij Ambra Nikulaj, Andri Nikulaj, Gleida Nikulaj, Luis Nikulaj të cilet e trashëgojnë në pjesë të barabarte pasurinë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e tij në të njëjtën masë.



A2023043370159956815

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, i nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterinë";

V E N D O S A:

1-Pranimin e kërkesës.

2-Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin **Ardian Nikulaj** duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë këta persona të cilët e trashëgojnë trashëgimlënësin në këtë masë:

1.Rudina	Engjell	Nikulaj	bashkëshortja	1/5 pjesë takuese
2.Ambra	Ardian	Nikulaj	e bija	1/5 pjesë takuese
3.Andri	Ardian	Nikulaj	i biri	1/5 pjesë takuese
4.Gleida	Ardian	Nikulaj	e bija	1/5 pjesë takuese
5.Luis	Ardian	Nikulaj	i biri	1/5 pjesë takuese

si dhe përgjigjen për detyrimet e tyre trashëgimore po në të njëjtën masë.

3-Kerkuesja mori dijeni se ka afat te regjistroje aktin e trashegimise ne DVASHK Lezhe brenda 30 diteve nga data e leshimit te deshmise se trashegimise.

4- Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

5- Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

U lëshua në Lezhë, sot më datë 10.06.2023.

NOTER**Vasil Gj. Martini**